



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2022:038712

Datë: 15.08.2024

Numri i dokumentit: 06054447

P.nr.142/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRI, Departamenti i përgjithshëm- Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.S. nga fshati ..., komuna Vushtri, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av.Beqir Halili, për shkak te veprës penale *Kanosja* nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1362/2021 të datës 28.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik të datës 18.07.2024, në praninë e prokurorit të shtetit, të pandehurit, mbrojtësit të tij si dhe të dëmtuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.08.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: F.S., nga i ati Sh..., e ëma F..., e vajzërisë H..., i lindur më ..., me vendbanim në fshatin ..., rr. "...", nr. ..., komuna Vushtri, i pa punë, me profesion marangoz, beqar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: I pandehuri me datë 02.08.2021 dhe 04.08.2021, rreth orës 10:46, në fshatin ..., komuna Vushtri, ku jeton M.B., seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë se do ti bëjë ndonjë të keqe, me qëllim të frikësimit dhe brengosjes, ose shkakimit të lëndimit të rëndë trupor, gjegjësisht të dëmtuarin M.B., pylltarin në pyllin shtetëror pranë Komunës së Vushtrrisë, i cili e takon të pandehurin në vendin e quajtur ..., në Vushtri, duke prerë drunjë, me traktor me ram, me datën 20.06.2021 rreth orës 11:15, ndërsa me datë 22.07.2021 rreth orës 15:10, kur ishte me sharrë motorike dhe me automjetin e tij duke kryer punën e tij zyrtare, pylltari i dëmtuar ka fotografuar traktorin me ram dhe 77 copë drunjë, për këtë arsye i pandehuri me datë 02.08.2021 fillimisht përmes rrjetit social facebook, i dërgon mesazh “vetëm po të paralajmëroj që të mos parashtrosh kallëzim penal, nëse kam kohë vijë deri në Vushtri të dielën”, i dëmtuari nuk është përgjigjur, andaj i pandehuri me datë 04.08.2021 e thërret në telefon nga numri ... në numrin ..., të cilin e ka përdorur pylltari dhe i thotë “nuk guxon ta parashtrosh kallëzimin, do të kesh punë me mua nëse

del në ..., pse e ke fotografuar traktorin dhe ramin, për çka i dëmtuari është ndjerë i rrezikuar dhe është frikësuar për jetën e tij, andaj e denoncon rastin në polici.

- Me këtë ka kryer veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, duke u bazuar ne dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 40, 46, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 181 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK, si dhe nenit 364, 449, dhe 452 të KPPK-së:

## GJYKON

Të pandehurit F.S. i shqipton DËNIM ME KUSHT ashtu që i vërteton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprën penale të re, në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Pala e dëmtuar M.B. ka heq dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 (njëzet) euro. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me datë 28.04.2022 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1362/2021, ndaj të pandehurit F.S. nga fshati ..., komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale *Kanosja* nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në të cilën aktakuzë, prokurori i shtetit ka kërkuar nga gjykata që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 18.07.2024, në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Shaqir Sedolli, i pandehuri F.S., mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av.Beqir Halili, si dhe i dëmtuari M.B..

### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me fajësinë*

Gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, pas leximit të aktakuzës, i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me pranimin ose jo të fajësisë.

I pandehuri F.S. ka deklaruar se e pranon fajësinë në tërësi sipas aktakuzës dhe ka shtuar se i ka kërkuar falje të dëmtuarit dhe i ka ardh keq që ka ndodh e gjithë kjo, po se nuk po di se çka të thotë, tutje ka shtuar se e ka një dorë të thyer që dy vite dhe nuk ka pasur mundësi të punojë dhe prapë në Janar do të hy në operim, andaj e ka lutur gjykatën që të i shqiptojë një dënim sa më të butë, duke theksuar se në të ardhmen kurrë nuk pritet më që të kryejë vepra penale të kësaj natyre, apo çfarëdo vepre tjetër.

#### *Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se deklarimi mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje dispozitat e KPPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, dhe i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, andaj nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë, i propozojmë gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë. Andaj, nëse gjykata e aprovon pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit propozon që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, ndërsa gjatë matjes së dënimit, përcaktimit të llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese edhe renduese, ashtu që si rrethana lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, kërkim faljen nga ana e tij, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh shkallën lartë të dashjes në drejtim të kryerjes së veprës penale, po ashtu prokurori i shtetit propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale dhe nëse nga ajo rezulton se i pandehuri është i dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese, sidomos nëse edhe më parë është dënuar për vepra të njëjta penale dhe e kundërta nëse nuk është dënuar më parë, ta merr parasysh se rrethanë lehtësuese.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me fjalën e prokurorit të shtetit, i pandehuri ka kërkuar falje, dhe se me të pandehurin nuk janë takuar më, ka vite që nuk janë takuar, por që e pranon kërkim faljen e tij, pasi që i pandehuri u zotua se në të ardhmen nuk do të përsërisë gabime të tilla. Tutje ka theksuar se nuk paraqet kërkesë pasurore juridike lidhur me këtë çështje.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pas konsultimit me të mbrojturin e tij, i njëjti në mënyrë vullnetare, pa imponim, i vetëdijshëm për përfitimet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, deklaroi se e pranon fajësinë, dhe shprehu keqardhje dhe bëri kërkim falje të dëmtuarit. Pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, andaj i ka propozuar gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë. Me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit i ka propozuar gjykatës që si rrethana lehtësuese ta marrë pranimin e fajësisë, se për herë të parë ka rënë në kundërshtim me ligjin, është i gjendjes së varfër ekonomike, është deklaruar se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale, prandaj i ka propozuar gjykatës që ti shqiptojë një dënim të kushtëzuar, me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

#### *Vlerësimi i gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë është në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së, kjo pasi që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se

pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

#### *Provat e vlerësuara nga gjykata*

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-BD-690, i datës 09.08.2021; procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit M.B., i datës 09.08.2021; procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit F.S., i datës 11.08.2021; raporti policor i datës 09.08.2021, procesverbali i marrjes në pyetje të të dëmtuarit M.B., i datës 02.03.2022 si dhe të dhënat e të pandehurit nga data baza e Policisë së Kosovës.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Gjyqtari i vetëm gjykues bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në deklarinimin e vetë të pandehurit, ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri F.S. me dashje ka kryer veprën penale *Kanosja* nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 181 par.1 të KPRK – së është parashikuar forma themelore e veprës penale *Kanosja* të cilën e kryen: “*Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.*”. Ndërsa në par. 3 i nenit 181 të KPRK-së është përcaktuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale, ku parashihet se: “*Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet*”, elemente këto të figurës së kësaj vepre penale që janë përmbushur tërësisht në këtë çështje penale.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje me të gjitha provat në shkresat e lëndës, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpallë fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, ngase veprimet e tij përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale e cila i ngarkohet dhe se për të njëjtën është penalisht përgjegjës.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 38, 69 dhe 70 të KPRK-së, ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, faktin se i pandehuri më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, keqardhjen e shprehur për atë që ka bërë si dhe kërkim faljen në drejtim të të dëmtuarit, ndërsa sa iu përket rrethanave renduese gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me rrethanat e kryerjes së veprave, shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Gjithashtu duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, gjykata ka vlerësuar se nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim më i rëndë apo më i butë, dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së dhe atë që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

*Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, i dëmtuari ka heqë dorë nga realizimi i kësaj kërkesë, konform nenit 460 të KPPRK-së, i cili parasheh se: *“Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe atë ta realizojnë në kontest civil...”*.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 452 par.4 të KPP-së, ndërsa vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartcekurat e bazuar në nenin 364 të KPPRK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr. 142/2022, datë 15.08.2024

Zyrtarja ligjore  
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Ferki Xhaferi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.